



UNIVERSITETI
UNIVERSITY
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Nr. 3226 dt. 23.11.2015

**UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"**

Pejë, 23.11.2015

Në bazë të nenit 19, paragrafi 1, të Ligjit për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës, si dhe në bazë të dispozitave të nenit 26 paragrafi 2 Këshilli Drejtues i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë në mbledhjen e mbajtur me datë 12.10.2015 ka nxjerr Vendimin me Ref. Nr. 3223 të datës 23.11.2015 për shpalljen e:

KONKURSI për zgjedhjen e Rektorit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, për pjesën e mbetur të mandatit.

Kushtet e përgjithshme

Konkurrimi për postin e Rektorit është i hapur për kandidatët e brendshëm dhe të jashtëm

Në pajtim me dispozitatet e nenit 27 të Statutit të Universitetit, kandidatët për Rektor duhet të plotësohen këto kushte:

1. Të ketë përvojë të dëshmuar në mësimdhënie akademike, kërkim shkencore;
2. Të ketë gradën më së paku të Profesorit të Asocuar;
3. Të ketë përvojë të dëshmuar menaxhuese universitare.

Kushtet e veçanta

1. Kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet formale për detyrën e Rektorit duhet të plotësojnë edhe këto kushte:
 - a. Të përgatisin një dosje me dokumentacion konkret dhe të besueshëm për thirrjet akademike dhe shkencore;
 - b. Dokumenteve të ia bashkëngjisin një CV të detajuar mbi punën menaxheriale, akademike, shkencore ose artistike;
 - c. Të sjellin dëshminë që nuk janë nën hetime;
 - d. Të jenë të gatshëm të intervistohen nga Këshilli Drejtues në mënyrë që të prezantojnë një vizion gjithëpërfshirës për zhvillimin e strategjisë së ardhshme të Universitetit dhe për qasjen e tij menaxhuese.

Dokumentacioni i të interesuarve dorëzohet në Rektoratin e Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, ose përmes postës zyrtare në adresën: **Rektorati i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, Rr. UÇK-së 30000 Pejë.**

Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e shpalljes publike në mjetet e informimit dhe në web-in e universitetit: www.unhz.eu